



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8.5.2023

Nr: 466

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**PROPOZIMIN E SANKSIONEVE ADMINISTRATIVE NDAJ DISA KRYETARËVE TË BASHKIVE PËR  
MOSDORËZIMIN E VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E  
BASHKIVE PËRKATËSE PËR AFISHIMIN PREJ SUBJEKTEVE ZGJEDHORE TË MATERIALEVE  
PROPAGANDISTIKE**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, dhe 2, nenit 79, pika 1 dhe nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Me shkresën nr. 4208 prot., datë 25.04.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u është drejtuar të gjitha bashkive për përcaktimin e vendeve publike në territorin në juridiksion të tyre, për afishimin e materialeve propagandistike të fushatës elektorale të subjekteve zgjedhore, detyrim ky që buron nga neni 79 i Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të udhëzimit nr. 6/2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, bashkitë kanë detyrimin të dorëzojnë vendimet e tyre në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga informacioni i administruar rezulton se 13 (trembëdhjetë) bashki nuk dorëzuar në KQZ vendimet e tyre.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, dhe 2, nenin 79, pika 1 dhe nenin 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhor”,

## V E N D O S:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative gjobë në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë për kryetarët e bashkive, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim do t’u njoftohet bashkive, nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

## Lidhja nr. 1

1. Z. Fran Tuci Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz;
2. Z. Andis Salla, Kryetar i Bashkisë Cërrik;
3. Z. Safet Gjici, Kryetar i Bashkisë Kukës;
4. Zj. Majlinda Qilimi, Kryetar i Bashkisë Delvinë;
5. Z. Adem Lala, Kryetar i Bashkisë Has;
6. Zj. Luiza Mandi, Kryetar i Bashkisë Libohovë;
7. Z. Elton Arbana, Kryetar i Bashkisë Shijak;
8. Z. Dritan Leli, Kryetar i Bashkisë Vlorë;
9. Z. Kreshnik Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë;
10. Z. Bardh Spahia, Kryetar i Bashkisë Shkodër;
11. Z. Mark Babani, Kryetar i Bashkisë Vau Dejës;
12. Z. Eduard Duro, Kryetar i Bashkisë Devoll;
13. Z. Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Bashkia Divjakë.